Ne fokus/ Tirana dhe Partizani kunder FSHF-se

nga AlbaniaSoccer
E enjte, 19 Shtator 2013 21:36

Kombetarja dhe ndeshja e saj qe do te luhet ne muajin tetor kane prishur planet e skuadrave te kryeqytetit. Tirana dhe Partizani jane te detyruara te luajne takimet e tyre te kampionatit ne mesdite pa mundur te luajne ne mbremje. FSHF ka dhene urdher qe para ndeshjes me Zvicren ne asnje rast te mos ndizen prozhektoret dhe ky urdher ka acaruar Tiranen dhe Partizanin qe do deshironin te luanin ne oret e mbremjes per te patur me teper tifoze dhe perfituar me shume para nga biletat.